

Përgjigje ndaj kërkesës me nr.rendor 3 në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj lidhur me vënien në dispozicion të studimeve të fizibilitetit për kontratën e koncesionit “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim, mirëmbajtje dhe transferim i segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier”; “Ndërtim dhe Mirëmbajtje e Aksit Rrugor "Thumanë–Fushë-Krujë–Vorë–Kashar””; si dhe për kontratën “Dhënie me Koncesion/PPP te Projektit te Rruges Porti i Jahteve -Orikum – Dukat”, mund t’ju sqarojmë si në vijim se:

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, asiston me ekspertizë ligjore, ekonomike dhe jo teknike Autoritetet Kontraktuese për procedurat e dhënies me koncesion/partneritet publik privat. Kësisoj janë Autoritetet Kontraktuese përgjegjëse për menaxhimin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP, ruajtjen e administrimin e dokumenteve përkatëse dhe rrjedhimisht kanë edhe informacionin që kërkohet nga ana juaj. Kështu për sa i përket disponimit të studimeve të kërkuara të fizibilitetit, lutemi ti drejtoheni pikërisht autoritetit përgjegjës mbi procedurat koncesionare në fjalë, që sipas VKM-së nr. 111, datë 02.03.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, i ndryshuar, është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë.